



Prokuroria në Gjilan del me njoftim për vrasjen e 37-vjeçarit



07/11/2024 16:27



Një 37 vjeçar dyshohet se është vvarë sot. Lajmin e konfirmoi zëdhënësi i Policisë për rajonin e Gjilanit.

Pak më parë, Prokuroria atje ka lëshuar një njoftim ku thuhet se prokurori kujdestar ka dalë në vendin e ngjarjes.

“Prokuroria Themelore në Gjilan, ju njofton se gjatë ditës së sotme, më datë 7 nëntor 2024, në rrugën “Mërgimtarët e Gjilanit”, në Gjilan, rreth orës 14h, një person është gjetur pa shenja jete.”

Prokuroria thotë se viktimë dyshohet se është qëlluar me armë zjarri.

“Prokurori kujdestar nga Departamenti për Krime të Rënda dhe njësitet tjera relevante menjëherë kanë dalë në vendin e ngjarjes, ku nga hetimet e para dyshohet se viktimë është qëlluar me armë zjarri dhe me urdhër të prokurorit trupi i pa jetë është dërguar për autopsi në Institutin e Mjekësisë Ligjore.”

“Prokuroria Themelore në Gjilan, në koordinim me Policinë e Kosovës – Njësinë e Hetimeve Rajonale në Gjilan, janë duke ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore, në mënyrë që të identifikohen personat e dyshuar. Për të gjitha veprimet e tjera do të jeni të njoftuar me kohë!”

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LuponMedia



Artikuj të ngjashëm



November 7, 2024
Operacioni “Tregu”, kapet shitësi i narkotikëve në Prishtinë



November 7, 2024
Maqedonci: Shërbime të huaja dashakeqe “ushqyen” lajmet për ushqimin e FSK-së...



November 7, 2024
Haradinaj i referohet Qeverisë Kurti si “e mjerë”: E futi Kosovën...



November 7, 2024
Deklarata për Trump e Grenell, Hoxhaj: S’besoj që në Washington e...



November 7, 2024
Hoxhaj beson se nëse rikthehet Richard Grenell në pushtet do ta...



November 7, 2024
Alija: Procesi i Hagës mund të përfundojë kah fund i vitit 2025



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyra nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information